



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 59 ,datë 26 / 06 /2025

“PËR NGRITJEN E KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE NË BASHKINË
KORÇË”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, bazuar në nenin 29 të ligjit 139/2015 « Për vetëqeverisjen vendore », si dhe në *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024, “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”* dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) pranë Bashkisë Korçë, si një mekanizëm koordinues ndërinstitucional për çështjet që lidhen me sigurinë në komunitet, i cili do të funksionojë bazuar në VKM-në 678 datë 30.10.2024.
2. Të miratojë përbërjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike pranë Bashkisë Korçë, si më poshtë:

Nr.	Emër & Mbiemër	Pozicioni	Institucioni	Nr. Tel.	Email
1	Sotiraq Filo	Kryetar i Bashkisë	Bashkia Korçë		
2	Agim Hoxha		Drejtoria Vendore e Policisë Korçë	0694100009	
3	Erald Kreka	Drejtor i Policisë Bashkiake	Bashkia Korçë	0685310013	erald.kreka@bashkia.korce.gov.al
4	Arjant Qasolli	Përgjegjës i Emergjencave Civile	Bashkia Korçë	0692137809	arjant.qasolli@bashkia.korce.gov.al
5	Inelda Malka	Koordinator Vendor për Dhunën në Marrëdhëniet Familjare	Bashkia Korçë	0692753289	inelda.hasankolli@bashkia.korce.gov.al
6	Joana Teneqexhi	Përfaqësues i Njesisë për	Bashkia Korçë	0697719701	joanateneqexhi23@gmail.com

		Mbrojtjen e Fëmijëve			
7	Idlir Limllari	Kryeinspektor i MT-së	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit – Bashkia Korçë	0697218602	idlir.limllari@bashkia.korce.gov.al
8	Lefter Kapurani	Specialist Jurist	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	0694768411	lefter.kapurani@arsimi.gov.al
9	Dorina Gjoka	Përfaqësuese	Shërbimi Social Shtetëror	0692440410	
10	Elona Mejdanlli	Përfaqësuese	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	0692150654	elonabiraku@yahoo.com
11	Gentino Jançe	Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të të Dhënave dhe Informacionit	Agjencia Rajonale e Mjedisit	0694243033	gentinojace@yahoo.com
12	Emiljano Kanani	Inspektor në Sektorin e Ushqimit	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit		
13	Olsi Duma	Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura	0683443879	olsi_duma@hotmail.com

3. Në rast ndryshimi të përfaqësuesit të ndonjë institucioni anëtar në përbërjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, nuk do të kërkohej ndryshim i këtij vendimi nga Këshilli Bashkiak. Institucioni përkatës njofton Bashkinë Korçë për përfaqësuesin e ri, duke garantuar përfaqësimin e pandërprerë institucional në KVSP.

4. Komisioni Vendor i Sigurisë Publike pranë Bashkisë Korçë zbaton funksionet e tij sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024, të cilat përfshijnë:

- Angazhimin për parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që cenojnë sigurinë në komunitet;
- Mbikëqytjen dhe zbatimin e planit vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
- Identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e problematikave lidhur me sigurinë në komunitet dhe trajtimin e tyre në mbledhjet e këshillit;
- Propozimin e zgjidhjeve për problematikat konkrete tek autoritetet kompetente shtetërore;
- Identifikimin e prioritetëve në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandimin për përfshirjen e tyre në mbledhjet e radhës;

- Vlerësimin dhe komunikimin e detajeve të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike në komunitet drejtuesve përkatës;
- Kontributin dhe sigurimin e pjesëmarrjes në aktivitete ndërgjegjëse për komunitetin dhe projekte për sigurinë në komunitet;
- Vendosjen me shumicën e votave të anëtarëve të këshillit;
- Shqyrtimin e përmbushjes së rekomandimeve për çështjet e trajtuara në KVSP;
- Përcaktimin e përbërjes së sekretariatit teknik të këshillit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.

6. Vendimi nr.25 datë 27.02.2020 i ndryshuar dhe Vendimi nr.148 datë 29.09.2022 të Këshillit Bashkiak Korçë shfuqizohen.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 27-06-2025

KRYETAR

